



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Dragas Municipality



KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 2 shkronja (d), neni 40 paragrafi 2 pika (j) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", neni 6 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 nënparagrafi 2.1, neni 18 i Ligjit për Bashkëpunim Ndër komunal nr. 04/-L-010 "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.07/2011, neni 6 i Rregullores për Procedurën e Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar, neni 32.2 i Statutit të Komunës së Dragashit - 01 Nr.06-103/1 të datës 11.09.2008, Kuvendi i Komunës në Dragash në mbledhjen e mbajtur me datën 02.06.2025 pas shqyrtimit dhe votimit paraprak, miraton këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E NISMËS PËR BASHKËPUNIM KOMUNAL NDËRKOMBËTAR DHE FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR BINJAKËZIMIN NDËRMJET KOMUNËS SË DRAGASHIT DHE KOMUNËS SË PURKERSDORF REPUBLIKA E AUSTRIËS

Neni I

MIRATOHET kërkesa – nisma e Kryetarit të Komunës së Dragashit, për vendosjen e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar – binjakëzimit me Qytetin / Komunës së Purkersdorf të Republikës së Austrisë.

Neni II

AUTORIZOHET Kryetari i Komunës së Dragashit z.Bexhet Xheladini që të filloj konsultimet me përfaqësuesit e Qytetit/ Komunës së Purkersdorf për përgatitjen e Marrëveshjes së bashkëpunimit të ndërsjellë.

Neni III

Vendimi, hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8 dhe nenit 9 të Ligjit Nr.08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 24/2024" dhe pas publikimit në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS - DRAGASH
01 Nr. 060/01-37010-1/25
Dt. 02.06.2025



Kryesuesja e Kuvendit
Anijeta Skeraj

Askeraj